



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr.283/9 Prot.

Tiranë, më 22.09.2026

V E N D I M

Nr. 173, datë 22.06.2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 44, datë 10.02.2026, e paraqitur nga z. O.K kundër Spitalit Universitar të Traumës (SUT), në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes arsimore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Ankuesi O.K, i punësuar pranë Spitalit Universitar të Traumës (SUT), i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me ankesë, kundër punëdhënësit/ SUT, duke pretenduar diskriminim të vazhdueshëm dhe trajtim të pabarabartë në marrëdhëniet e punës.

Ankuesi parashtroi se, me vendimin nr. 231, datë 22.12.2022, Komisioneri ka konstatuar diskriminim ndaj tij dhe ka urdhëruar rikthimin e tij në pozicionin e Kryeinfermierit, pozicion që mbante para trajtimit të pabarabartë të konstatuar. Në zbatim të këtij vendimi, me vendimin nr. 1318, datë 12.12.2023, titullarja e SUT e riktheu ankuesin në detyrën e Kryeinfermierit të Bllokut Operator. Megjithatë, ankuesi parashtroi se sjellja diskriminuese ndaj tij nuk pushoi pas riemërimit, por vijoi dhe u intensifikua me veprime të njëpasnjëshme.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ankuesi parashtroi se, menjëherë pas riemërimit të tij në detyrën e Kryeinfermierit me vendimin nr. 1318, datë 12.12.2023, titullarja urdhëroi Sektorin e IT të SUT-it të instalonte kamera survejuese brenda ambientit të zyrës së tij. Ankuesi thekson se zyra ka qenë dhe mbetet funksionale, e identifikueshme me tabelën përkatëse "Kryeinfermier", njëllonj si çdo zyrë tjetër e Kryeinfermierëve apo Shefave të Shërbimeve në institucion.

Ankuesit nuk iu dha asnjë informacion, as verbal e as me shkrim, lidhur me vendosjen e kamerave brenda ambientit të zyrës së tij. Ai thekson se asnjë zyrë tjetër e Kryeinfermierëve apo e Shefave të Shërbimeve nuk disponon kamera survejuese brenda ambientit të punës, ndërkohë që korridoret dhe hollet e ndërtesës janë të pajisura me kamera.

Ankuesi paraqiti ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me datë 20.12.2025. Me shkresën nr. 67/4 Prot., datë 23.01.2026, me lëndë "*Kthim Përgjigje*", Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pranoi argumentimin e SUT se kamerat ishin instaluar për të ruajtur materialet e kushtueshme ortopedike të osteosintezës të magazinuara në ambientet e Bllokut Operator. Ankuesi e kundërshton këtë argument, duke theksuar se materiale të njëjta ndodheshin edhe në sallën ku kryheshin ndërhyrjet neuro kirurgjikale, si dhe në ambientet e kolegut të tij, gjithashtu Kryeinfermier brenda Bllokut Operator, pa asnjë kamerë survejuese brenda zyrës. Sipas ankuesit, qëllimi i vërtetë i instalimit të kamerave ka qenë kontrolli, intimidimi, persekutimi dhe demotivimi i tij si hakmarrje për ankesat e paraqitura ndaj titullares pranë Komisionerit.

Ankuesi parashtroi se, me urdhrin nr. 1383, datë 03.12.2025, titullarja e SUT urdhëroi riorganizimin e Shërbimit të Urgjencës dhe dy ditë më vonë, me vendimin nr. 1401, datë 05.12.2025, ai u komandua nga pozicioni i Kryeinfermierit të Bllokut Operator në pozicionin e Infermierit në Bllokun Operator të Urgjencës, duke humbur të gjitha funksionet dhe atributet e Kryeinfermierit dhe duke u bërë vartës i Kryeinfermieres së Bllokut Operator të Urgjencës. Ankuesi thekson se trajtimi i tij ka qenë thelbi i ndryshëm nga ai i punonjësve të tjerë të prekur nga e njëjta masë riorganizimi, konkretisht:

- Shefi i Shërbimit të Bllokut Operator u komandua në pozicionin e Shefit të Bllokut Operator të Urgjencës, duke ruajtur titullin dhe funksionin;
- Kolegu K. L, Kryeinfermier brenda të njëjtit Bllok Operator, u transferua në një shërbim tjetër duke ruajtur pozicionin dhe titullin e Kryeinfermierit, edhe pse në shërbimin ku u transferua ekzistonte tashmë një Kryeinfermier tjetër në detyrë;
- Të gjithë infermierët e tjerë u komanduan në të njëjtin pozicion që kishin, pra si infermierë.

Sipas ankuesit, vetëm ai u ul në detyrë, nga Kryeinfermier në Infermier, pa njoftim paraprak, pa procedurë dëgjimore, pa arsyetim të motivuar me shkrim dhe pa shkaqe objektive që të justifikonin trajtimin e ndryshëm. Ankuesi mbështetet gjithashtu në Rregulloren për Funksionimin e SUT-it, nr. 2667/2, datë 25.03.2024, sipas së cilës vendimmarrja për lëvizje në detyrë të Kryeinfermierit kërkon

mendimin e Kryeinfermierit të Përgjithshëm dhe miratimin e Shefit të Shërbimit, procedurë e cila nuk u ndoq.

Ankuesi kundërshton qëndrimin e SUT-it duke u mbështetur në dispozitat e Kodit të Punës (nenet 9, 21, 22, 32, 144, 146, 149, 153), në udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe në Kontratën Kolektive të Punës, duke argumentuar se çdo ulje në detyrë duhet të ketë arsyetim të dokumentuar, të ruajë titullin dhe gradën profesionale dhe të garantojë të drejtën e dëgjimit të punonjësit.

Më tej, ankuesi parashtroi se me datë 10.12.2025, pesë ditë pas nxjerrjes së vendimit nr. 1401, datë 05.12.2025, dhe ndërkohë që kishte paraqitur tashmë ankimim kundër këtij vendimi, ndodhi një incident në korridorin e Bllokut Operator, të cilin, sipas ankuesit, Komisioni i Etikës e cilësoi unanimisht si keqkuptim. Megjithatë titullarja i vendosi masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” me urdhrin nr. 137, datë 05.02.2026, rreth tre muaj pas ngjarjes. Ankuesi e cilëson këtë masë disiplinore si hakmarrje të drejtpërdrejtë për ankimimet e paraqitura si pranë Komisionerit ashtu edhe pranë gjykatës.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë në marrëdhënie pune. Rekomandimin e ndërprerjes së sjelljes diskriminuese dhe rikthimin e tij në një pozicion ekuivalent me funksionin dhe titullin e Kryeinfermierit. Marrjen e çdo mase tjetër që Komisioneri e çmon të nevojshme për eliminimin e pasojave të diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh, ndërsa garanton në mënyrë të shprehur mbrojtje nga diskriminimi për shkak të *gjendjes ekonomike dhe gjendjes arsimore*. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: ***“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”***

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”,* ndërsa në nenin 12, *“Ndalimi i diskriminimit”*, pika 1, germa “c”, të po këtij ligji, parashikohet: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.282/2 prot., datë 26.02.2026, Komisioneri njoftoi subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa dhe kërkoi informacion në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë.
2. Me shkresën nr. 1660/1 prot datë 12.03.2026, ka kthyer përgjigje SUT, duke parashtruar ndër të tjera:

Lidhur me kontekstin e rikonstruksionit, SUT sqaron se institucioni ndodhet në proces rikonstruksioni të Godinës së Korpusit Qendror, bazuar në Kontratën e Sipërmarrjes nr. 50/2 Prot., datë 15.01.2025, të lidhur ndërmjet SUT dhe shoqërisë “Alba Konstruksion” shpk, me objekt *“Rikonstruksion i Godinës së Korpusit Qendror dhe Sistemi i Ambienteve të Jashtme të Spitalit Universitar të Traumës”*. Rikonstruksioni përfshin edhe Bllokun Operator, ambient i kontrolluar dhe steril ku kryhen ndërhyrjet kirurgjikale, i cili aktualisht ndodhet në kushte fizike të papërshtatshme për funksionim. Rrjedhimisht, SUT ka qenë në pamundësi objektive të vazhdimit të aktivitetit të këtij shërbimi gjatë periudhës së punimeve.

Lidhur me ligjshmërinë e komandimit, SUT parashtron se vendimi nr. 1401, datë 05.12.2025, me objekt *"Për komandime në detyrë punonjës infermierë në SUT"*, ka komanduar të gjithë personelin infermior të Bllokut Operator pranë Shërbimit të Urgjencës, për nevoja pune dhe për arsye të rikonstruksionit. Afati i komandimit u përcaktua me vendimin nr. 44, datë 15.01.2026, *"Për një ndryshim në vendimin nr. 5021 Prot., datë 05.12.2025"*, duke parashikuar fillimin e komandimit me datë 09.12.2025 deri në përfundim të rikonstruksionit të Bllokut Operator.

SUT argumentoi se ankuesi ngatërron nocionin e vënies në dispozicion të punëmarrësve, të parashikuar nga neni 137, i Kodit të Punës, me komandimin me urdhër të brendshëm brenda të njëjtit institucion. Sipas SUT, komandimi i kryer nuk ka ndryshuar marrëdhënien e punës ndërmjet palëve, nuk ka ndryshuar kontratën individuale të punës, pozicionin e punës apo trajtimin financiar të ankuesit. Qëllimi i aktit administrativ të nxjerrë ka qenë mirëadministrimi i punës në institucion në kushtet e rikonstruksionit, dhe jo ndryshimi i kushteve thelbësore të punës.

Lidhur me pretendimin e uljes në detyrë dhe diskriminimit, SUT kundërshton kategorikisht pretendimet e ankuesit, duke parashtruar se O.K kryen të njëjtën punë dhe gëzon të njëjtin trajtim financiar si para komandimit, me ndryshimin e vetëm se ka ndryshuar shërbimi ku ai ushtron detyrën. SUT pohoi gjithashtu se, struktura infermiore e çdo shërbimi pranë institucionit parashikon një Kryeinfermier dhe pjesën tjetër infermierë, dhe se O.K mbetet Kryeinfermier i Bllokut Operator. Komandimi i tij pranë Shërbimit të Urgjencës gjatë periudhës së rikonstruksionit nuk e ndryshon këtë cilësi dhe nuk përbën ulje në detyrë.

SUT u shpreh se parimet e barazisë dhe ndalimit të diskriminimit nuk janë cenuar në asnjë moment ndaj ankuesit O.K , as ndaj ndonjë punëmarrësi tjetër të institucionit.

Lidhur me çështjet gjyqësore, SUT njoftoi Komisionerin se ankuesi ka ngritur dy kërkesëpadi: njëra me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 1401, datë 05.12.2025, rikthimin në detyrën e Kryeinfermierit dhe detyrimin e SUT për respektimin e të drejtave të punës dhe tjetra, me objekt dëmshpërblimin e ankuesit për dëmin pasuror dhe jo pasuror në masën 3.000.000 lekë, të pretenduar si pasojë e diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë.

3. Ankuesi ka depozituar prapësimet e tij në lidhje me qëndrimin e dërguar nga SUT, të cilat janë administruar me nr.282/4 prot., datë 24.03.2026.

Lidhur me pretendimin se ankuesi "kryen të njëjtën punë", ankuesi argumentoi se ky pretendim mbetet deklarativ dhe i paprovuar, pasi SUT nuk paraqiti asnjë dokument mbështetës, as strukturën dhe organikën, as procedurën e ndjekur për komandim dhe as prova mbi barazinë e funksioneve apo të pagës. Në thelb, ankuesi u kalua nga funksion drejtues në funksion ekzekutiv, i janë hequr përgjegjësitë drejtuese dhe është vendosur në varësi të një Kryeinfermiereje tjetër, çka sipas tij përbën ulje në detyrë *de facto* në kundërshtim me nenet 21 dhe 22 të Kodit të Punës.

Lidhur me rastet krahasimore, ankuesi u mbështet në urdhrin nr. 1474, datë 30.12.2025, i cili konfirmon mbylljen e plotë të Shërbimit të Bllokut Operator të Këmbës Diabetike. Pavarësisht kësaj, kolegu K.L u komandua duke ruajtur titullin dhe funksionin e Kryeinfermierit, ashtu si dhe Shefi i Shërbimit. Ndërkohë, vetëm ankuesi u ul në detyrë dhe u vendos në varësi, çka përbën trajtim të pabarabartë për situata të krahasueshme.

Lidhur me ndryshimin e vendimit nr. 1401, datë 05.12.2025, ankuesi argumentoi se vendimi nr. 44, datë 15.01.2026, i nxjerrë pas ndërhyrjes së Inspektoratit Shtetëror të Punës me shkresën nr. 5901/3 Prot., datë 16.01.2026, përbën pranim të tërthortë të paligjshmërisë së aktit fillestar. Megjithatë, mosrivendosja e tij në pozicionin e mëparshëm përbën, sipas ankuesit, viktimizim të ndaluar nga neni 3, pika 8 i Ligjit nr. 10221/2010, si dhe trajtim penalizues për shkak të ushtrimit të të drejtave ligjore.

4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore në datën 07.05.2026. Seanca dëgjimore iu komunikua palëve me shkresën nr. 282/5 prot., datë 21.04.2026.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e të dy palëve, ankuesit O.K , i cili u paraqit personalisht si dhe përfaqësuesit të tij sipas deklaramit të bërë gjatë seancës, Av.D. N, me nr.license nr.4292, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe SUT, përfaqësuar nga I.D, sipas autorizimit nr.3778 prot., datë 06.05.2026.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 3496 prot., datë 08.05.2026, SUT ka dërguar dokumentacion plotësues në vijim të seancës dëgjimore, për të cilin ka kërkuar ruajtjen e konfidencialitetit, pasi lidhet edhe me personel/staf ushtarak.
6. Në datën 08.06.2026, ankuesi ka depozituar pranë Komisionerit (administruar me nr.282/8 prot) dokumentacion plotësues, ndër të tjera kopje të kërkesë padisë që ka paraqitur në gjykatë për kundërshtimin e urdhrin nr.137, datë 05.02.2026 për dhënien e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim”.

Nga aktet e administruara konstatohet se, ankuesi O.K , ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore vendimin nr. 1401, datë 05.12.2025 *“Për komandime në detyrë punonjës infermierë në SUT”*, nëpërmjet të cilit është komanduar nga detyra si kryeinfermier në infermier dhe urdhrin nr. 137, datë 05.02.2026 për dhënien e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim”. Konkretisht, ankuesi ka paraqitur dy kërkesë padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kundër SUT, respektivisht me objekt:

Padia e parë me objekt: *“1. Shfuqizimi i vendimit administrativ nr. 1401, datë 05.12.2025 të Spitalit Universitar të Traumës, pavlefshmëri absolute e vendimit. 2. Rikthimi i paditësit në detyrën*

e Kryeinfermierit, në të njëjtat kushte dhe me të njëjtin titull funksional të mëparshëm. 3. Njohja e pavlefshmërisë së uljes në detyrë si akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me ligjin. 4. Detyrimin e palës së paditur për respektimin e të drejtave të punës sipas Kodit të Punës dhe akteve nënligjore të Ministrisë së Shëndetësisë.”

Komisioneri konstaton se, në parashtrimet e kërkesë padisë së bërë nga pala ankuese pranë Gjykatës, ndër të tjera pretendohet shkelja e parimit të barazisë dhe ndalimit të diskriminimit, duke parashtruar në lidhje me këtë pretendim se: *“.....Sa më sipër, i gjithë personeli i Bllokut Operator duke filluar nga Shefi i Shërbimit i cili është komanduar Shef i Bllokut Operator të Urgjencës (nuk i ka ndryshuar titulli dhe pozicioni), edhe pse aty është një Shef, si edhe infermierët janë transferuar, komanduar në pozicione ekuivalente, vetëm paditë si është ulur në detyrë dhe mungon çdo kriter objektiv dallues. Ky trajtim përbën diskriminim të drejtpërdrejtë administrativ.....”*

Padia e dytë me objekt: *“Shfuqizimi i urdhrit nr.137, datë 05.02.2026 dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute të masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”. Heqje e masës nga dosja personale. Ngarkimin e palës së paditur me shpenzimet gjyqësore.”*

Komisioneri konstaton se, në parashtrimet e kërkesë padisë së bërë nga pala ankuese pranë Gjykatës, ndër të tjera parashtron: *“.....paditë si ka marrë vendim në favorin e tij nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), duke konfirmuar shkeljen e të drejtave të tij. Paditësi ka hapur sërish padi në KMD dhe Gjykatë për çështje të tjera të trajtimit të tij nga institucioni. Ky model i përsëritur i shkeljeve dhe masave të padrejta tregon hakmarrje (retaliation), duke e bërë vendimin e datës 05.02.2026 një akt diskriminues dhe cenues të reputacionit profesional.....”*

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga pala ankuese në këtë proces, Komisioneri vëren se, në analizë të dy kërkesë padive të ankuesit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (në vijim Gjykatës), rezulton se pala ankuese ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor pretendimet për diskriminim në lidhje me komandimin nga detyra Kryeinfermier në Infermier, sipas vendimit nr.1401, datë 05.12.2025 dhe masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim”, sipas urdhrit nr.137, datë 05.02.2026.

Referuar të dy kërkesë padive të depozituara para Gjykatës, pala ankuese pretendon se, përveç shkeljeve të tjera ligjore, komandimi nga detyra Kryeinfermier në Infermier, sipas vendimit nr.1401, datë 05.12.2025 dhe masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim”, sipas urdhrit nr.137, datë 05.02.2026, janë akte diskriminuese.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të

paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.....”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pala ankuese, në të dy kërkesë paditë e paraqitura pranë Gjykatës, ka pretenduar *inter alia*, se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit/ SUT, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime që ka sjellë paralelisht edhe pranë Komisionerit.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: “...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet lidhur me pretendimet e ngritura nga z. O.K në ankesën nr. 44, datë 10.02.2026, kundër Spitalit Universitar të Traumës, në lidhje me, komandimin nga detyra e Kryeinfermierit të Bllokut Operator në detyrën e Infermierit në Bllokun Operator të Urgjencës, sipas vendimit nr. 1401, datë 05.12.2025 dhe masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”, sipas urdhrit nr. 137, datë 05.02.2026, për shkak se këto pretendime janë objekt gjykimi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe deklarën pushimin e shqyrtimit të ankesës për këto pretendime.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë³, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

- Në lidhje me pretendimin për diskriminim për instalimin e kamerave survejuese brenda ambientit të zyrës së ankuesit

³ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.

Nga aktet e administruara, rezulton se, ankuesi i është drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP), me ankesën nr.3287 prot., datë 23.12.2025, nëpërmjet të cilës ka pretenduar se në zyrën e tij të punës në SUT është vendosur një kamera me qëllim monitorimin e veprimtarisë së tij. Ankuesi pretendon se një veprim i tillë nga punëdhënësi/SUT është ndërmarrë vetëm ndaj tij.

Në përfundim të procedurës së hetimit administrativ, me shkresën nr. 67/4 prot., datë 23.01.2026, KDIMDHP, ka informuar ankuesin se, nga verifikimet e kryera rezultoi se përpunimi i të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejitimit CCTV, është realizuar mbi bazën e një interesi të ligjshëm, në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr.124/2025 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij, duke mos konstatuar shkelje.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të ligjit nr. 124/2025 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është organi i specializuar dhe i pavarur, i ngarkuar me kompetencën ligjore për të vlerësuar ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale, përfshirë vendosjen dhe funksionimin e sistemeve të video-survejitimit (CCTV) nga subjektet publike e private. Në kuadër të kësaj kompetence, KDIMDHP ka kryer procedurën e hetimit administrativ mbi rastin konkret të ankuesit dhe, me shkresën nr. 67/4 prot., datë 23.01.2026, ka konkluduar se vendosja dhe funksionimi i kamerave të video-survejitimit nga SUT janë realizuar mbi bazën e një interesi të ligjshëm, në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke mos konstatuar asnjë shkelje në këtë drejtim.

Komisioneri nuk mund të rivlerësojë, ndryshojë apo anashkalojë konstatimet e arritura nga KDIMDHP brenda fushës së kompetencës së tij ligjore, pasi kjo do të përbënte ndërhyrje në kompetencat e një organi tjetër të specializuar.

Për sa kohë organi kompetent, KDIMDHP, ka konstatuar se vendosja e kamerave nga SUT nuk përbën shkelje të dispozitave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, pretendimet e ankuesit kundër këtij konstatimi, përfshirë argumentet e tij lidhur me mungesën e informimit apo veprimet e kryera nga KDIMDHP gjatë hetimit administrativ të realizuar për shqyrtimin e ankesë së paraqitur nga ankuesi, nuk mund të vlerësohen nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi një vlerësim i tillë do të nënkuptonte një rishqyrtim *de facto* të vendimit të KDIMDHP-së, çka tejkalon kompetencat e Komisionerit.

Ankuesi pretendon se vendosja e kamerës në zyrën e tij ka ndodhur menjëherë pas rikthimit të tij në detyrën e Kryeinfermierit me vendimin nr. 1318, datë 12.12.2023, duke nënkuptuar kështu një lidhje shkakësore ndërmjet këtij veprimi dhe ankesave të tij të mëparshme ndaj titullares pranë Komisionerit. Komisioneri vlerëson se, përtej parashtrimit të vetë ankuesit, nuk u administruan asnjë fakt, dokument apo provë e tjetër, që të vërtetojë se vendosja e kamerës ka ndodhur në kohën dhe në mënyrën e pretenduar apo që të krijojë një lidhje kohore dhe logjike mes këtij veprimi dhe riemërimit/ankesave të ankuesit.

Pretendimin për cenimin e privatësisë dhe vendosjen e kamerave në mënyrë selektive ankuesi e ka parashtruar pranë KDIMDHP me ankesën nr.3287 prot., datë 23.12.2025 dhe njëkohësisht pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë nëpërmjet ankesës nr.5901 prot., datë 24.12.2025.

Me shkresën nr.5901/3 prot., datë 16.01.2026, Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së Tiranë, ka informuar ankuesin se, për shkak se në zyrë kishte filluar puna për rikonstruksionin, inspektorët nuk mundën të verifikojnë objektin e kamerës dhe vendosjen e saj.

Ankuesi pretendoi se ka paraqitur ankesa pranë SUT në lidhje me vendosjen e kamerave, por nga aktet e administruara pretendimi nuk rezultoi i provuar. Gjithashtu, në të dy ankesat drejtuar KDIMDHP dhe Drejtorisë Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë, ankuesi nuk paraqet ndonjë informacion në lidhje me momentin e vendosjes së kamerave.

Në rastin konkret, nuk rezultoi i provuar fakti themelor mbi të cilin mbështetet pretendimi i ankuesit, përkatësisht koha dhe rrethanat e vendosjes së kamerës dhe lidhja e saj kohore me riemërimin dhe ankimimet e mëparshme pranë Komisionerit, që pretendohet nga ankuesi si shkak diskriminues. Ankuesi është rikthyer në detyrë në datë 12.12.2023, ndërsa pretendimet për cenimin e privatësisë dhe vendosjes selektive të kamerave janë paraqitur fillimisht në datën 23.12.2025 pranë KDIMDHP dhe në datë 24.12.2025 pranë Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së Tiranë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administruan fakte ose prova të tjera që të hedhin poshtë përfundimet e KDIMDHP, si organi i specializuar për mbrojtjen e të dhënave personale ose që të provojnë se ankuesi është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga SUT për shkakun e pretenduar/ankimimet e mëparshme pranë Komisionerit.

Përfundimisht, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankuesit për diskriminim në lidhje me vendosjen e kamerave të video-survejitimit në ambientin e zyrës së tij, është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pikat 7/4, 10, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga z. O.K në ankesën nr. 44, datë 10.02.2026, kundër Spitalit Universitar të Traumës, në lidhje me, komandimin nga detyra e Kryeinfermierit të Bllokut Operator në detyrën e Infermierit në Bllokun Operator të Urgjencës, sipas vendimit nr. 1401, datë 05.12.2025; dhe masën disiplinore "Vërejtje me paralajmërim",

sipas urdhrit nr. 137, datë 05.02.2026, për shkak se këto pretendime janë objekt gjykimi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

2. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit O.K nga Spitali Universitar i Traumës, në lidhje me pretendimin për vendosjen e kamerave të video-survejimit në ambientin e zyrës së tij.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

Shkaku: “gjendja ekonomike”, “gjendja arsimore” dhe “çdo shkak tjetër”

Fusha: Punësim

Lloji vendimit: Pushim gjykatë/Mosdiskriminim